



I dashur Prind/Kujdestar:

Në epokën e celularëve, smartfonëve dhe paisje të tjera elektronike, të cilat mundet që me lehtësi të bëjnë fotografi dhe t'i shpërndajnë ato në çast, konfidencialiteti dhe siguria e materialeve të testeve, mundet të kompromentohen lehtësisht. Jo vetëm për faktin që është e kushtueshme zëvendësimi i materialeve të kompromentuara, por materiali që gjendet në testin e PSSA dhe Provimeve Keystone (Keystone Exams), është pasuri dhe e drejtë e Shtetit të Pensilvanisë. Kopjimi dhe dublikimi i materialeve nga testi, përfshirë edhe marrjen e fotografive, është në shkelje të Ligjit Federal për të drejtat e autorit (Copyright Act). Dënimet për shkeljen e këtij ligji, mund të përfshijnë koston e zëvendësimit të pjesëve të kompromentuara, ose gjobë jo më pak se \$750 deri në \$30,000 , për një shkelje të vetme. 17 U.S.C. § 101 et seq.

Në mënyrë që të garantohet besueshmëria në rezultatet e testeve, dhe të shmanget kostoja e zëvendësimit të tyre, Departamenti i Arsimit kërkon që shkollat të vendosin rregulla dhe të marrin masa për ruajtjen e materialeve të testeve. Një masë, ose rregull kërkon që të mos lejon në mjediset e testit paisjet elektronike. Këto paisje përfshijnë celularët, smartphones, E-readers, Nooks, Kindles, iPads, iPods, tablets, camera-ready devices, dhe të tjera, të cilat mund të përdoren për fotografi, ose dublikim të materialeve të testeve, lidhje me internetin dhe/ose komunikim me të tjerët gjatë procesit të provimeve të PSSA ose Keystone Exams. Ju lutemi bisedoni me fëmijën tuaj dhe i bëni me dije se mbajtja dhe/ose përdorimi i celularit, ose paisjeve të tjera elektronike gjatë testimit të PSSA ose Keystone Exams , do të ketë pasoja.

Ju do të kontaktoheni nga shkolla, në rast se do të rezultojë që fëmija juaj ka/ose përdor paisje elektronike gjatë testit të PSSA ose Keystone Exams. Nxënësit që nuk i përmbahen këtij rregulli, do të jenë subjekt i masave disiplinore të shkollës dhe kërkesave të Departamentit të Arsimit, për përjashtim nga testi dhe përsëritjen e plotë të këtij testi. Në vazhdim, do të mbahen paisjet elektronike dhe do të kontrollohen fotot e ruajtura në to. Personeli i shkollës do të kërkojë leje për kontrollin e funksioneve të tjera të paisjes elektronike. Në rast se zbulohen foto të testit, ose refuzohet leja për kontrollin e funksioneve të tjera të paisjes, paisja do të mbahet nga personeli, sepse Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë ka të drejtat e autorit për materialet që përmbajnë testet e PSSA dhe Keystone Exams. Në këtë rast do të kontaktohet edhe Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë, për veprime të mëtejshme.

Në rastet kur pas përfundimit të testit dhe dorëzimit të materialeve zbulohet që një nxënës ka patur, ose/dhe ka përdorur paisje elektronike gjatë kohës së testit, do të zbatohet politika disiplinore e shkollës dhe rezultati i testit të nxënësit do të bëhet i pavlefshëm.